



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. 18873 Prot

Shkodër, më 20.07.2026

Lënda: Dërgohet projekt- vendim dhe relacion



KËSHILLIT BASHKIAK, SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur ju dërgojmë për kompetencë shqyrtimi projekt-vendimin dhe relacionin:

Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira të ekonomisë pyjore “PrueMos Sheldi”, Njësia administrative Rrethina , ngastra 50a, për vazhdimin e operimit te antenes të komunikimit të kompanisë të telefonisë celulare “One Albania sh.a”

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. 18873/1 Prot

Shkodër, më 20.07.2026

PROJEKT VENDIM

NR. _____, DATË _____.____.2026

PËR DHËNIE PËLQIMI PËR DHËNIE ME QIRA TË EKONOMISË PYJORE “PRUEMOS SHELDI”, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRETHINA , NGA STRA 50A, PËR VAZHDIMIN E OPERIMIT TË ANTENËS SË KOMUNKIMIT TË KOMPANISË TË TELEFONISË CELULARE “ONE ALBANIA SH.A”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës _____.____.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 54 shkronja “e/1” e ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar ; neni 12 i ligjit nr.57/2020 “Për pyjet” i ndryshuar VKM nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” të ndryshuar ; VKM nr 559 datë 29.07.2022 Për përcaktimin e cmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjorë kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore,” Udhëzimit të Ministrisë Mjedisit nr.1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” , dhe sipas relacionit nr. _____ prot, datë _____ të Drejtorisë së Mjedisit dhe Energjisë së Rinovueshme

V E N D O S I :

1. Dhënien e pëlqimit për dhënie me qira të ekonomisë pyjore “Pruemos Sheldi” njësi administrative Rrethina, Bashkia Shkodër , ngastra 50 a, me sipërfaqe 250 m2, dhe gjatësi rruge 0.89 km , me afat 5 vjeçar, për vazhdimin e operimit të antenës të komunikimit celular të operatorit të telefonisë celulare ‘One Albania’ sh.a, sipas planimetrisë bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI



Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, tëb: ëëë.bashkia@shkodër.gov.al, e-mail: info@bashkia@shkodër.gov.al

Zy.Kryetar

Alban Zekaj

Drejtoria e Përgjithëshme e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit

Abel Zepaj

Drejtoria e Mjedisit dhe Energjisë Së Rinovueshme

Eda Shkaku

Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerezore dhe Shërbimeve Mbeshtetese

[Signature]

Drejtoria Juridike

[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E MJEDISIT DHE ENERGJISË SË RINOVUESHME

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2026

RELACION

Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira të ekonomisë pyjore “Prueños Sheldi”, Njësia administrative Rrethina , ngastra 50a, për vazhdimin e operimit të antenes të komunikimit të kompanisë të telefonisë celulare “One Albania sh.a”

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Shkodër

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Shkodër në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj ka edhe administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Pjesë e këtij administrimi është edhe dhënia me qira/përdorim e këtij fondi pyjor nëpërmjet të tretëve.

Kompania “One Albania sh.a” ka paraqitur kërkesën e saj nr 383 prot dt 06.03.2023 administruar pranë Bashkisë Shkodër me nr 5652 prot dt 10.03.2026 “Për rinovimin e kontratës së qirasë për antenën e instaluar në sipërfaqen pyjore në ekonominë pyjore “Prueños Sheldi”, Njësia administrative Rrethina , ngastra 50a “, për të cilën ka pasur një kontratë me Bashkinë Shkodër 5 vjecare për periudhën prej 18.09.2021 deri 17.09.2026.

Aktualisht , vazhdon që parcela në të cilën është ndërtuar antena e komunikimit të jetw pjese e inventarit të pronave të Bashkisë Shkodër, kjo bazuar në në VKM nr. 433 dt 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të MM e të ish Komunave/Bashkive”. i ndryshuar.

Bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr 1 datë 09.06.2016 “ Për rregullat , procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, pika 22/g, përjashton nga konkurimi publik dhënie në përdorim të sipërfaqeve për ...ndertimin e antenave të komunikimit radiotelevizive dhe telefonisë celulare.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “One Albania sh.a”, që në momentin e lidhjes së kontratës fillestare (18.09.2021) është konform pikës 22 g të këtij Udhëzimi dhe përbëhet nga:

- a) leja/licenca përkatëse nga institucioni qendror për ushtrimin e veprimtarisë;
- b) kontratat ekzistuese të lidhura me autoritetet përkatëse (Bashkia Shkodër),
- c) projektin teknik të zbatimit.
- d) hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në formatin PDF dhe në format elektronik në shkallën 1:10000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: zona kadastrale sipas ZRPP-së, kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, si dhe lidhjen me të dhënat për treguesit kadastrale pyjorë dhe kullosorë;
- e) lejen e mjedisit
- f) lejen e ndërtimit;
- g) aktin e regjistrimit pranë QKR-sëe

Po ashtu që në momentin e lidhjes së kontratës fillestare ka qene realizuar edhe Raporti teknik.

Aktualisht Subjekti / ONE Albania ka të shlyera të gjitha detyimet sipas kontratës..

Bazuar në ligjin nr 57/2020 “Për pyjet”, i ndryshuar VKM nr 559 datë 29.07.2022 Për përcaktimin e cmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjorë kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore,” Shtojca I , pika 7 dhe 11 , në bazë të “përdorimit të territorit” dhe afatit të dhënies në përdorim janë përcaktuar tarifat si më poshtë

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit		Vlera në lek
		Për vendosje antene të telefonisë fikse, të lëvizshme, televizione, radio-komunikimit		
		1-5 vjet	Sipërfaqe/ rrugë në përdorim	
1	Pyje Trungishte (Prumos Sheldi)	11.250.000lek/ha/vit	0.025ha	281,250 lek/vit
2	Rrugë (Trungishte)	70.000 lek/km vit	0.89km	62,300 lek/vit
	TOTAL			343,550 lek/vit

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.2 c, neni 54 pika e, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë tjetërsimi apo dhënie me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Bazuar në sa më sipër propozojmë miratimin e dhënies në përdorim me qira për një afat 5 vjeçar, për sipërfaqen 250 m² (0.025 ha) për stacion ku janë instaluar antenat dhe aksesorët e saj si edhe rrugen e përdorimit në gjatësinë 890 m me vlerën 343,550 lek/vit.

Duke ju falenderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit

Drejtorja e Mjedisit dhe Energjisë së Rinovueshme


Drejtore

Aida Shllaku

KRYETAR


Benet BECI

PLANVENDOSJE E RRUGES SE AKSESIT TE STACIONIT "ONE ALBANIA" SH.A, SHKODRA NEW 1272 H=48m SH 1:2500



Plani Topografik 1:10,000

Plani Kadastral 1:5000



Pole / Mast ONE	
Pole / Mast jete te teta	
Rruges e detruar per stacionet	
Rruges	
Prerje	
Park / Zona e shpalluar / Peme	
Pemset ne majet	
Nr Rendit i nives se aksit	
Line Tension Elektrike	
Kabine Elektrike	
Shifra Elektrike	
Kuarta topografike (mondi)	

Pika	E (m)	N (m)	Z (m)
1	379663.145	4658395.061	123.52
2	379684.182	4658394.741	123.3
3	379707.782	4658394.207	122.39
4	379710.665	4658402.424	121.84
5	379684.93	4658405.625	118.88
6	379632.166	4658432.319	112.6
7	379581.578	4658398.402	103.48
8	379531.791	4658393.445	93.9
9	379499.841	4658389.52	88.26
10	379430.768	4658425.436	74.34
11	379361.289	4658417.814	64.97
12	379301.844	4658395.889	54.87
13	379257.822	4658421.578	46.63
14	379177.954	4658390.098	33.9
15	379127.586	4658301.83	24.34
16	379100.194	4658242.634	20.41
17	379050.091	4658203.244	18.33
18	379045.348	4658168.187	17.51

Shenime:
Gjatesia totale e muges: 890m
E gjitha permardhet jete ne mjetet nese nuk specifikohet ndryshe
Sistemi koordinatues / paskajues i muges: UTM Zone 34N

ONE Albania sh.a
Adresa: Rr. "Muhamdi Llagam", Kompleksi "Square21", Tirane, Shqiperi

one

Planvendosja e stacionit:
Stacioni: "Shkodra new"
Site Code: 1272
Adresa: Krr. e Bokave te Siperme Shkoder

Shkalla 1:2500 **Fila** 2 nga 2

Formali A3 (297x420) **Data** 08/07/2026

Inzhineri Gjendet **Fabion Kurti**

Luenga T.1626

Konsulent **Decagon shpk**
NIPIT: M327274030
Adresa: Pallati n.20, Gati i parë, Nr. Paullatës 1/331-148, 24, 8532,
Lugut e Shkoderës, Shkoderë, Rr. Shkoderës